Dhikri më i mirë është: "La ilahe il-lallah", ndërsa lutja më e mirë është: "Elhamdulilah

Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëguar të Dërguarin e Allahut të thotë: "Dhikri më i mirë është: "La ilahe il-lallah", ndërsa lutja më e mirë është: "Elhamdulilah."

[Hasen] [Transmetojnë Tirmidhiu, Nesaiu në “Es-Sunen el-kubra” dhe Ibn Maxhe]

Profeti na tregon në këtë hadith se dhikri (përmendja e Allahut) më i mirë është: “La ilahe il-lallah”, që do të thotë se s'ka të adhuruar të denjë përveç Allahut, e lutja më e mirë është: "Elhamdulilah (çdo lavdërim i takon Allahut)", që nënkupton pranimin se Dhuruesi është Allahu i Lartësuar, Meritori për cilësitë e përsosura dhe të bukura.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/3567